



UNIVERSITETI I EJL
ЈНЕ УНИВЕРЗИТЕТ
SEE UNIVERSITY

K O N K U R S

***Për regjistrimin e studentëve në fakultetet e Universitetit të Evropës Juglindore
për vitin akademik 2011/2012, sipas modelit të cikleve të studimeve***

Në bazë të nenit 108, të Ligjit për arsimin e lartë (Fletorja zyrtare e R. Maqedonisë, nr. 35/2008, 103/2008, 26/2009, 83/2009 dhe 99/2009), Rregullores për kriteret e regjistrimit në studime në Universitetin e Evropës Juglindore dhe vendimit të Senatit të Universitetit të EJL, më 12.04.2011, Këshilli i Rektorit të Universitetit të EJL-së shpall:

K O N K U R S

Për regjistrimin e studentëve në vitin e parë të studimeve, të ciklit të parë dhe të dytë, në fakultetet e UEJL-së, për vitin akademik 2011/2012.

-I-

STUDENTËT NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE (TREVJEÇARE DHE KATËRVJEÇARE¹)

1. Numri i studentëve me studime të rregullta për vitin akademik 2011/2012.

Në studime të rregullta në këtë vit akademik do të pranohet numri i studentëve sipas strukturës vijuese:

a. Studentë në studime të rregullta në Tetovë²

Fakultetet	Me mësim në gjuhën shqipe	Me mësim në gjuhën maqedonase	Me mësim në gjuhën angleze	Çmimi i studimeve (për semestër)
Fakulteti i Drejtësisë:				
- Drejtësi	100	-	-	650 €
- Kriminalistikë dhe Siguri	60	-	-	
Fakulteti i Biznesit dhe Ekonomisë:				
- Administrimi i Biznesit	120	30	30	900 €
- Ekonomiku	50	-	-	
- Agrobiznesi	20	-	-	
- Turizmi	20	-	-	
Fakulteti i Administrimit Publik dhe Shkencave Politike:				
- Studime të Administrimit Publik	120	30	-	650 €
- Shkencat Politike	40	-	-	
- Liderhipi dhe Puna me Rininë në Shoqëri ³	-	-	20	
Fakulteti i Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore:				
- Shkencat Kompjuterike	80	20	30	900 €
- Inxhinieria Kompjuterike	-	-	30	1000 €
- Informatika e Biznesit	-	-	80	
Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit:				
- Gjuhë dhe Letërsi Shqipe	25			650 €
- Gjuhë dhe Letërsi Angleze	-		130	
- Gjuhë dhe Letërsi Gjermane	25			
- Shkencat e Komunikimit	25	-	-	

¹ Studentët në programet e Drejtësisë, Administrimit e Biznesit, Administrim Publik dhe Shkenca Politike, Shkencat Kompjuterike, Gjuhë Shqipe, Gjuhë Angleze, Gjuhë Gjermane dhe Shkencat e Komunikimit, pas përfundimit të studimeve trevjeçare (që marrin diplomën për përfundimin e ciklit të parë të studimeve), nëse dëshirojnë mund të vazhdojnë edhe studimin shtesë njëvjeçar, pas përfundimit të të cilit mund të marrin edhe diplomën për përfundimin e ciklit të parë me 240 ECTS kredi – katërvjeçare.

² Çmimi për studentët ndërkombëtarë (jashtë shteteve fqinje) në programet studimore në gjuhën angleze është 1000 € për semestër .

³ Program që realizohet në bashkëpunim me Universitetin Joncheping – Suedi.

b. Studentë në studime të rregullta në Shkup⁴

Fakultetet	Me mësim në gjuhën shqipe	Me mësim në gjuhën maqedonase	Me mësim në gjuhën angleze	Çmimi i studimeve (për semestër)
Fakulteti i Drejtësisë	40	40	-	650 €
Fakulteti i Biznesit dhe Ekonomisë:				
- Administrimi i Biznesit	-	-	25	1000 €
- Sistemet e Informacionit dhe Menaxhmenti ⁵	-	-	20	- € ⁴
Fakulteti i Administrimit Publik dhe Shkencave Politike:				
- Administrimi Publik	25	25	-	650 €
- Shkenca Politike	-	25	-	
Fakulteti i Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore:				
- Informatika e Biznesit	-	-	25	1000 €
- Shkenca Kompjuterike	-	-	25	
Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit:				
- Shkenca e Komunikimit	-	20	-	650 €

2. Numri i studentëve në studimet me korrespondencë

Në fakultetet e UEJL-së, në vitin e parë të studimeve, në vitin 2011/2012, në studimet me korrespondencë sipas programit në distancë, do të regjistrohet numër i studentëve në masë deri në 30% nga numri i përgjithshëm i paraparë me konkursin për studentë të rregullt, sipas programeve studimore:

a. Studime me korrespondencë në Tetovë

Fakultetet	Çmimi i studimeve (për semestër)
Fakulteti i Drejtësisë	450 €
Fakulteti i Biznesit dhe Ekonomisë: - Administrimi i biznesit	650 €
Fakulteti i Administrimit Publik dhe Shkencave Politike: - Studime të Administrimit Publik - Shkenca Politike	450 €
Fakulteti i Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore - Shkenca Kompjuterike	650 €
Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit - Gjuhë dhe Letërsi Angleze	450 €

b. Studime me korrespondencë, në Shkup

Fakultetet	Çmimi i studimeve (për semestër)
Fakulteti i Drejtësisë	450 €
Fakulteti i Biznesit dhe Ekonomisë - Administrimi i Biznesit	650 €

⁴ Studentët të cilët do të studiojnë në qytezën universitare, në Shkup, një ditë në javë do ta ndjekin mësimin në qytezën universitare, në Tetovë

⁵ Programi studimor zhvillohet në kuadër të bashkëpunimit me Universitetin e Londrës – “London School of Economics” (LSE) – External Programme. Bëhet fjalë për konceptin e “diplomës së dyfishtë”, ku studenti pajiset me dy diploma (atë të LSE dhe atë të UEJL). Kushtet e regjistrimit janë të parapara në mënyrë të veçantë në konkursin shtesë. Mësimi realizohet në gjuhë angleze.

Fakulteti i Administrimit Publik dhe Shkencave Politike - Studime të Administrimit Publik	450 €
Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit - Shkenca e Komunikimit	450 €

Studimet me korrespondencë nënkuptojnë studimin e pavarur sipas udhëzimeve dhe standardeve të universitetit. Regjimi i studimit është si vijon:

- studentët në fillim të semestrit mbajnë ligjëratën hyrëse me profesorin e lëndës;
- lëndët e shkathtësive (si p.sh. gjuha angleze dhe teknologjia e informacionit do të zhvillohen me mësim të drejtpërdrejtë, njëherë në dy javë, pas orarit të punës, varësisht nga niveli i njohurive paraprake);
- duke shfrytëzuar sistemin elektronik të menaxhimit të lëndëve "Libri" (libri.seeu.edu.mk), do të udhëzohen për mënyrën e studimit vetanak, me kriteret e vlerësimit, materialin e nevojshëm dhe me mundësinë e pjesëmarrjes në forumin elektronik;
- në përfundim të semestrit do të organizohet seminar intensiv me profesorët e lëndëve;

VËREJTJE (për seksionin 1 dhe 2):

- Në rast të paraqitjes së kandidatëve në numër më të madh se numri i paraparë në këtë konkurs dhe të njëjtit nëse vlerësohen se i plotësojnë kriteret dhe standardet e kërkuara për regjistrim në UEJL, atëherë Këshilli i Rektorit mund të vendosë që të pranojë më së shumti deri në 20% prej tyre nga numri i paraparë me konkurs.
- Në rast të paraqitjes më pak se 20 kandidatë në programin studimor, Universiteti mban të drejtën që të mos e hapë drejtimin përkatës dhe kandidatëve gjegjësisht u ofron mundësi që të regjistrohen në ndonjë program tjetër studimor.
- Rregullat e studimit për të gjithë studentët janë të shpallura në "Përmbledhjen e akteve normative për qeverisjen dhe regjimin e studimeve", në ueb faqen e Universitetit.

3. Disa aspekte nga kushtet dhe kriteret për regjistrim

Kushtet dhe kriteret për regjistrimin e studentëve të rregullt dhe me korrespondencë

- a. Të drejtë regjistrimi në Universitet kanë kandidatët që kanë të kryer arsimin e mesëm katërvjeçar (të nostrifikuar),⁶ ose ekuivalentin e tij dhe që kanë kaluar maturën shtetërore.
- b. Në rast se në afatin e parë të regjistrimit nuk është plotësuar numri i paraparë me konkurs, atëherë të drejtë regjistrimi në afatin e dytë, përveç atyre që kanë kaluar maturën shtetërore, të cilët kanë përparësi për t'u regjistruar, këtë të drejtë e kanë edhe kandidatët e gjimnazeve që kanë kaluar maturën shkollore dhe kandidatët nga shkollat e mesme profesionale që kanë dhënë provimin përfundimtar.
- c. Kandidatët që kanë kryer arsimin e mesëm katërvjeçar ose ekuivalentin e tij para vitit 2008, kanë të drejtë të regjistrohen vetëm në bazë të suksesit të shkollës së mesme.
- d. Kandidatët që kanë kryer arsimin e mesëm katërvjeçar ose ekuivalentin e tij jashtë Republikës së Maqedonisë, kanë të drejtë të regjistrohen, bazuar në suksesin e shkollës së mesme (dëftesat dhe diploma), që ndërkohë duhet ta nostrifikojnë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës së Republikës së Maqedonisë.
- e. Vlerësimi i suksesit nga shkolla e mesme dhe matura shtetërore, si dhe matura shkollore për nxënësit në gjimnazet e përgjithshme apo provimi përfundimtar për ata që kanë kryer në shkollat profesionale (për kandidatët në afatin e dytë të pranimit), shprehet me anë të pikëve. Në bazë të pikëve do të bëhet edhe renditja e kandidatëve.
- f. Kandidatët regjistrohen si studentë të rregullt apo me korrespondencë me financim të studimeve.
- g. Përparësi gjatë pranimit të studentëve me korrespondencë do të kenë kandidatët që kanë statusin e të punësuarit dhe që kanë sukses më të lartë nga shkollimi i mesëm. Të punësuarit duhet ta dokumentojnë statusin e tyre.
- h. Të gjithë kandidatët do t'i nënshtrohen testimit të njohurive nga gjuha angleze. Ky testim, për programet që zhvillohen në gjuhën shqipe dhe maqedonase, nuk është eliminues, por nevojitet për përcaktimin e nivelit të njohjes së gjuhës angleze. Për studimet që zhvillohen në gjuhën angleze, testimi i njohjes së

⁶ Kandidatët që kanë diplomuar në universitete jashtë Republikës së Maqedonisë sipas Ligjit për arsim të lartë janë të obliguar që të bëjnë nostrifikimin e diplomës në Ministrinë e Arsimit të RM dhe për të cilën çështje, shërbimet e universitetit do t'ju ndihmojnë. Për përgjigje eventuale negative apo mosdhënie të përgjigjes, kandidatit do t'i ndërpriten studimet pa asnjë obligim nga UEJL.

gjuhës angleze është eliminues. Kushtet (pikët) minimale do të shfaqen në ueb-faqen e universitetit dhe në materialet plotësuese-udhëzimi për t'u përgatitur për testim.

Regjimi i studimeve

Regjimi i studimeve i zgjedhur për studim nga kandidati që në fazën e aplikimit, mbetet regjimi i studimeve deri në diplomim, pa mundësi të ndryshimit të tij.

Vlerësimi i suksesit

Vlerësimi i suksesit do të shprehet me anë të pikëve, respektivisht do të kalkulohet sukcesi i shkollës së mesme dhe provimi i maturës. Vlerësimi i këtyre dijeve do të bëhet sipas dy kriterëve:

- sukcesi i treguar në shkollën e mesme (gjimnaz apo shkollimin e mesëm profesional) dhe
- sukcesi i treguar në provimin e maturës.

4. Afatet e paraqitjes dhe regjistrimit

Paraqitja e interesimit - pararegjistrimi, mund të bëhet nga data 28 mars dhe do të zgjasë deri më 17 gusht. Kandidatët që aplikojnë para afatit të parë të maturës shtetërore, e fitojnë të drejtën e rezervimit të vendit në programin në të cilin kanë aplikuar, duke pasur parasysh se programet janë konkurruese dhe nuk mund të regjistrohen më shumë studentë se sa janë paraparë me konkurs. Këta kandidatë duhet të sjellin dokumentacionin e përshkruar më poshtë dhe atë: pikën 1, 2, 3 (për ato që është e aplikueshme), 4 (vetëm dëftesat e tre viteve të përfunduara), 6 dhe 7.

Regjistrimi i këtyre kandidatëve zyrtarizohet pas kompletimit të dokumentacionit.

Paraqitja e kandidatëve

Të drejtë paraqitjeje kanë të gjithë kandidatët që i përmbushin kushtet e parapara me konkurs.

Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e përmendura në pikën III, në ndërtesën 802, në qytezën universitare ose nëpërmjet postës, në adresën:

Universiteti i Evropës Juglindore
Rr. Ilindenit pn
1220 Tetovë, Maqedoni

Telefonat e kontaktit: 044356 091; 044 356 188;

Dokumentet për paraqitje në konkurs dhe regjistrim për të gjithë kandidatët

Të gjithë studentët duhet t'i dorëzojnë këto dokumente për të aplikuar për vitin akademik 2011/2012:

1. Formularin e plotësuar (i cili mund të merret në zyrat e Universitetit ose në ueb-faqen zyrtare të Universitetit www.seeu.edu.mk) dhe fletëpagesën (PP10), në shumë prej 1500 denarë, në adresën:

STOPANSKA BANKA
Llogaria rrjedhëse: 200-000877547449
Numri tatimor: 4028003134292

2. Biografinë e shkurtër në formë eseje ose letërinterimesi. Në këtë ese duhet të përmenden arsyet pse studentin aplikon në Universitetin e EJL dhe çka pret ai. Eseja duhet të shkruhet në bazë të aftësive të të shprehurit që paraqet mundësinë për ese konciz dhe origjinal, që do të shpalosë aspekte të caktuara të karakteristikave të personalitetit të studentit, biografinë e tij ose interesimin e tij.

3. Diplomën origjinale për kryerjen e arsimit të mesëm (për studentët që kanë kryer shkollimin e mesëm para vitit 2008 apo jashtë Republikës së Maqedonisë).

4. Dëftesat origjinale nga të gjitha vitet (ose kopje të verifikuara në noter).

5. Vërtetimin e rezultateve nga matura shtetërore, gjegjësisht matura shkollërore apo provimi përfundimtar.

6. Certifikatën e datëlindjes.
7. Fotokopjen e letërnjoftimit ose të pasaportës.

-II-

REGJISTRIMI I STUDENTËVE NË CIKLIN E DYTË PËR VITIN AKADEMIK 2011/2012

1. Regjistrimi i studentëve në studimet e ciklit të dytë (pasdiplomike) dyvjeçare, sipas modelit 3+2, në fakultetet e UEJL-së, për vitin akademik 2011/2012

Programet studimore në Tetovë

Programet studimore dyvjeçare të ciklit të dytë (studimet pasdiplomike), që ofrohen për vitin akademik 2011/2012, në fakultetet e UEJL-së, në Tetovë, janë si vijon:

Fakultetet	Nr. i studentëve	Çmimi i studimeve (për semestër)
Fakulteti i Drejtësisë:		
- E Drejta Penale	30	900 €
- E Drejta Civile	30	
- Marrëdhëniet Ndërkombëtare ⁷	20	
- Studimet e Sigurisë	20	
Fakulteti i Biznesit dhe Ekonomisë (drejtimet):		
- Financa dhe Kontabilitet	50	900 €
- Menaxhment	50	
- Menaxhimi me Shëndetësinë	20	
Fakulteti i Administrimit Publik dhe Shkencave Politike:		
- Studime të Administrimit Publik	20	900 €
- Shkenca Politike	20	
Fakulteti i Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore:		
- Menaxhimi me Bazat e të Dhënave ⁶	20	900 €
Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit:		
- Mësimdhënia e Gjuhës Angleze	60	900 €
- Studimet e Gjermanishtes	15	
- Gjuhë Shqipe dhe Letërsi	15	
- Studimet për Mësimdhënie	15	

Programet studimore në Shkup⁸

Programet studimore dyvjeçare të ciklit të dytë (studimet pasdiplomike), që ofrohen për vitin akademik 2011/2012, në fakultetet e UEJL-së, në Shkup, janë si vijon:

Fakultetet	Nr. i studentëve	Çmimi i studimeve (për semestër)
Fakulteti i Drejtësisë:		
- E Drejta Ndërkombëtare	20	900 €
Fakulteti i Biznesit dhe Ekonomisë (drejtimet):		
- Ndërmarrësia dhe Zhvillimi Ekonomik Lokal ⁶	15	900€
Fakulteti i Administrimit Publik dhe Shkencave Politike:		
- Studime për Diplomaci	25	900 €
Fakulteti i Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore:		

⁷ Programet zhvillohen në gjuhë angleze.

⁸ Studentet të cilët do të studiojnë në qytezën universitare, në Shkup, një ditë në javë do të ndjekin mësimin në qytezën universitare, në Tetovë

- Informatika e Biznesit ⁶	30	900 €
Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit:		
- Marrëdhëniet me Publikun dhe Komunikimi i Marketingut	25	900 €

- Në rast të paraqitjes së më pak se 15 kandidatëve në programin studimor, Universiteti e mban të drejtën që të mos e hapë drejtimin përkatës dhe kandidatëve gjegjësisht u ofron mundësi që të regjistrohen në ndonjë program tjetër studimor.

2. Regjistrimi i studentëve në ciklin e dytë të studimeve (pasdiplomike) tresemestrare, sipas modelit 4+1, në fakultetet e UEJL-së, për vitin akademik 2011/2012

Programet studimore në Tetovë

Programet studimore tresemestrare të ciklit të dytë (studimet pasdiplomike), që ofrohen për vitin akademik 2011/2012, në fakultetet e UEJL-së, në Tetovë, janë si vijon:

Fakultetet	Nr. i studentëve	Çmimi i studimeve (për semestër)
Fakulteti i Biznesit dhe Ekonomisë:		
- Financë	25	900 €
- Menaxhment	25	
Fakulteti i Administrimit Publik dhe Shkencave Politike:		
- Studime për Diplomaci	25	900 €
Fakulteti i Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore:		
- Zhvillimi i Softuerit dhe Aplikacioneve ⁹	20	900 €

Programet studimore në Shkup¹⁰

Programet studimore tresemestrare të ciklit të dytë (studimet pasdiplomike), që ofrohen për vitin akademik 2011/2012, në fakultetet e UEJL-së, në Shkup, janë si vijon:

Fakultetet	Nr. i studentëve	Çmimi i studimeve (për semestër)
Fakulteti i Drejtësisë:		
- E Drejta Penale	25	900 €
- E Drejta Civile	25	

- Në rast të paraqitjes më pak se 15 kandidatë në programin studimor, Universiteti mban të drejtën që të mos e hapë drejtimin përkatës dhe kandidatëve gjegjësisht t'ju ofrojë mundësi që të regjistrohen në ndonjë program tjetër studimor.

-III-

REGJISTRIMI I STUDENTËVE SIPAS SISTEMIT "ON-LINE"¹¹

Programet studimore, që ofrohen për vitin akademik 2011/2012, në fakultetet e UEJL-së, në Tetovë, sipas sistemit "on-line", janë si vijon:

Fakultetet	Nr. i studentëve	Çmimi i studimeve (për semestër)
------------	------------------	----------------------------------

⁹ Mësimi realizohet në gjuhën angleze

¹⁰ Studentet të cilët do të studiojnë në qytezën universitare, në Shkup, një ditë në javë do të ndjekin mësimin në qytezën universitare, në Tetovë

¹¹ Çmimi për studentët ndërkombëtarë (jashtë shteteve fqinje) në programet studimore në gjuhën angleze është 1000 € për semestër.

Fakulteti i Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore:		
Cikli i parë – Shkencat kompjuterike ¹²	20	650 €
Cikli i dytë - Informatika e Biznesit ¹²	20	650 €
Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit:		
Cikli i dytë - Mësimdhënia e Gjuhës Angleze	20	650 €

Të gjitha shërbimet në këtë program unik do të jenë “on-line”, deri në marrjen e diplomës. Më tepër informata për realizimin e këtij programi mund t’i gjeni në ueb faqen e universitetit.

Njohja e gjuhëve

Të gjitha programet studimore, në të dy konkurset për ciklin e dytë të studimeve pasdiplomike (sipas modelit dyvjeçar dhe atij tresemstral), ofrohen në gjuhën shqipe dhe në gjuhën maqedonase, përveç programeve të shënuara që do të zhvillohen vetëm në gjuhën angleze. Megjithatë, Universiteti e mban të drejtën e zhvillimit të pjesëve të ligjëratave apo lëndëve në gjuhën angleze, prandaj njohja e gjuhës shqipe, maqedonase dhe angleze është e nevojshme, kurse njohja në nivel akademik e së paku dy nga gjuhët e përmendura, është e obligueshme.

Për programet që zhvillohen në gjuhë angleze, do të organizohet testim përkatës për njohjen e nivelit të gjuhës angleze. Minimumi i pikëve është kusht i domosdoshëm për pranim në këto programe. Kushtet dhe materialet për përgatitjen e testimit pranues nga gjuha angleze mund t’i gjeni në ueb faqen e universitetit.

Kushtet dhe kriteret për regjistrim të studentëve të rregullt

1. Të drejtë regjistrimi në regjimin e studimeve pasdiplomike të ciklit të dytë, sipas modelit 3+2 (dyvjeçare) kanë kandidatët, që kanë diplomë (të nostrifikuar)¹³ universiteti (të ciklit të parë), ose ekuivalente me studimet trevjeçare (180 ECTS kredi) apo katërvjeçare (240 ECTS).
2. Të drejtë regjistrimi në regjimin e studimeve pasdiplomike të ciklit të dytë, sipas modelit 4+1 (tresemstral), kanë kandidatët, që kanë diplomë (të nostrifikuar) universiteti (të ciklit të parë), ose ekuivalente me studimet katërvjeçare (240 ECTS kredi).
3. Lëndët do të jenë të rregullta dhe modulare sipas sistemit: 50% e plan-programit të fakultetit përkatës zhvillohet në formë të rregullt, ndërsa pjesa tjetër e programit do të mund të kryhet me studime individuale (sipas udhëzimeve të mësimdhënësit). Lëndët e rregullta, zakonisht ofrohen çdo të dytën javë pas orës 16:00, ndërsa të shtunën nga ora 8:00, me qëllim që t’ju përshtaten kandidatëve që janë në marrëdhënie të rregullt pune. Ndërkaq, në rastet e lëndëve modulare (kur kemi profesorë të huaj), ligjëratat mund të jenë intensive.
4. Përparësi do të kenë studentët, të cilët gjatë studimeve të ciklit të parë kanë arritur notën mesatare 8.00 e më lartë.
5. Në rast se në programin përkatës studimor nuk paraqitet numër i mjaftueshëm i kandidatëve, atëherë në atë program nuk do të organizohet mësimi.
6. Në rastin kur aplikuesi ka përfunduar ciklin e parë në një lëmi që nuk është adekuate me programin studimor të ciklit të dytë në të cilin konkurron, atëherë për kushtet eventuale të përshtatjes së njohurive paraprake për regjistrim të programit do të vendosë komisioni i formuar nga fakulteti përkatës.

Afatet e paraqitjes dhe regjistrimit për studimet e ciklit të dytë (pasdiplomike) dyvjeçare, sipas modeleve 3+2 dhe 4+1

Paraqitja e kandidatëve me dokumentacionin përkatës të definuar në kushtet e konkursit do të bëhet nga 14 qershor deri më 14 shtator të vitit 2011.

Të drejtë paraqitjeje kanë të gjithë kandidatët që i plotësojnë kushtet e parapara me konkurs.

Për informata më të hollësishme kontaktoni Zyrën për studime pasdiplomike

Rr. Ilindenit pn

¹² Mësimi do të zhvillohet në gjuhën angleze

¹³ Kandidatët që kanë diplomuar në universitetet jashtë Republikës së Maqedonisë sipas Ligjit për arsim sipëror janë të obliguar që të bëjnë nostrifikimin e diplomës në Ministrinë e Arsimit të RM, ku do të kenë edhe ndihmën e shërbimeve të universitetit. Në rast të përgjigjes eventuale negative apo mosdhënies së përgjigjes, kandidatit do t’i ndërpriten studimet pa asnjë obligim nga UEJL.

1220 Tetovë, Maqedoni

Telefoni për kontakt: +389 044 356 081

NDIHMA FINANCIARE PËR STUDENTËT E RINJ, VITI AKADEMIK 2011/2012

Universiteti i Evropës Juglindore në bashkëpunim me miqtë, mbështetës të UEJL-së, donatorë të jashtëm dhe sponsorë nga komuniteti i biznesit, ofron përkrahje financiare përmes pakove të ndryshme financiare për studentët e rinj që do të regjistrohen në vitin akademik 2011/12 në ciklin e parë të studimeve.

Format e përkrahjeve financiare:

- **Bursa dhe grante**
- **Programi “Puno dhe studio”**
- **Përkrahje financiare për studentin e dytë apo të tretë të familjes**
- **Kredi studentore**

162 BURSA PËR STUDENTËT E RINJ

Bursat dhe grantet paraqesin një formë të përkrahjes financiare për studentët, të specifikuar në programe të veçanta të bursave që ofrohen nga Universiteti, donatorë të jashtëm si dhe komuniteti i biznesit. Bursat kryesisht akordohen në bazë të **meritës** ndërsa grantet në bazë të **nevojës financiare** të studentit.

Të gjitha bursat dhe grantet janë të vazhdueshme nga viti në vit deri në përfundim të ciklit të parë të studimeve trevjeçare. Kushtet për vazhdim të bursave specifikohen në letrën e akordimit të bursës.

1. Programi i bursave meritore të UEJL-së

90 bursa meritore për studentët e rinj që do të regjistrohen në vitin akademik 2011/12 në ciklin e parë të studimeve.

Numri i bursave meritore të UEJL-së

Numri dhe shpërndarja e bursave meritore të UEJL-së sipas fakulteteve, programeve studimore, gjuhës së studimit dhe lartësisë së bursës vjetore (në Euro) është dhënë në tabelën në vijim:

Fakulteti	Programi studimor	Gjuha e studimit			Bursa Gjithsej	Lartësia e bursës sipas kategorisë dhe programit studimor		
		Gjuhë Shqipe	Gjuhë Maqedonase	Gjuhë Angleze		Grupi A ≥ 95 pikë	Grupi B ≥ 85 pikë	Grupi C ≥ 70 pikë
BE	Administrimi i Biznesit	7	2	/	9	1600 Euro	1200 Euro	900 Euro
	Administrimi i Biznesit				3			1000 Euro
	Ekonomiku	5			5			900 Euro
	Turizmi	3			3			
	Sist. e Informacionit dhe Menaxhmenti			3	3			
SHTB	Shkencat Kompjuterike	8	2	/	10	1600 Euro	1200 Euro	1000 Euro
	Inxhinieria Kompjuterike	4	1	/	5			
	Informatika e Biznesit			8	8			
DREJTESI	Drejtësi (me përjashtim Kriminalistika)	19	4	/	23	1100 Euro	850 Euro	650 euro
APSHP	Administrimi Publik dhe Shkencat Politike	8	2	/	10			
GJKK	Gjuhë dhe Letërsi Angleze			7	7			
	Shkencat e Komunikimit	1	1	/	2			
	Gjuhë dhe Letërsi Gjermane				1			
	Gjuhë dhe Letërsi Shqipe	1			1			
Gjithsejtë					90			

Kriteret e akordimit të bursës meritore të UEJL-së (komponentët e vlerësimit)

- Testim në programin e zgjedhur studimor max. 50 pikë
- Testim i njohjes së gjuhës angleze max. 30 pikë
- Suksesi nga shkolla e mesme max. 20 pikë

Për kualifikim në këtë program bursash kandidati duhet të arrij të paktën 70 nga 100 pikë të mundshme nga tre komponentët e lartshënuara, ndërsa rangimi do të bëhet sipas pikëve të arritura.

Kategoritë e bursave sipas pikëve të arritura

Bursat meritorë të UEJL-së kategorizohen në tre grupe A,B dhe C varësisht nga pikët e testit profesional dhe pikët nga suksesi i shkollimit të mesëm.

Kategoria e bursës	Grupi A	Grupi B	Grupi C
Numri i pikëve	≥ 95 pikë	≥ 85 pikë	≥ 70 pikë

2. Programi i bursave të fondit “HESP” (Higher Education Support Program)

50 bursa sipas nevojës financiare (grante), UEJL në bashkëpunime me Institutin Shoqëri e Hapur (Open Society Institute), Programi për përkrahje të arsimit të lartë (Higher Education Support Program), ofron për kandidatët që do të përcaktohen të studiojnë në këto fakultete:

Fakulteti	Numri i bursave
Fakulteti i Administrimit Publik dhe Shkencave Politike	rreth 25 bursa
Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit	rreth 25 bursa

Fondi i bursave mundëson:

- pagesë të pjesshme të shkollimit - shuma maksimale **1000,- euro**
- dhe shpenzime të pjesshme për transport - shuma maksimale **600,- euro**

Shënim: Lartësia e bursës do të varet nga nevoja për ndihmë financiare të çdo studenti në veçanti.

Për kualifikim në këtë program bursash kandidati duhet të arrij të paktën 60 nga 100 pikë të mundshme nga tre komponentët e lartshënuara, ndërsa përzgjedhja e bursistëve do të bëhet në bazë të gjendjes financiare të studentit.

Gjatë përzgjedhjes së bursistëve përparësi do të kenë studentët me aftësi të kufizuara!

Të drejtë aplikimi kanë studentët shtetas të Maqedonisë që do të regjistrohen në studime të rregullta.

Informata rreth afatit dhe mënyrës së aplikimit mund të merren në ueb faqen e universitetit www.seeu.edu.mk ose në Zyrën për ndihma financiare në UEJL.

3. Programi i bursave nga komuniteti i biznesit “INVESTONI NË TË ARDHMEN TUAJ”

UEJL në bashkëpunim me komunitetin e biznesit, përmes programit të UEJL-së “Investoni në të ardhmen tuaj” do të mundësoj **20 bursa për studentët e rinj** që do të regjistrohen në vitin akademik 2011/2012. Përkrahja financiare që mundësohet nga financimi i i komunitetit të biznesit është si në vijim :

3.1 Bursa të kompanisë “ALMA-M”

- **9 bursa** për ciklin e parë të studimeve

3.2 Bursa të kompanisë “ECOLOG”

- **7 bursa** për ciklin e dytë të studimeve

3.3 Bursa të kompanisë “DAUTI KOMERC”

- **2 bursa** për ciklin e parë të studimeve

3.4 Bursë e kompanisë “VEZË SHARRI”

- **1 bursë** për ciklin e parë të studimeve

3.5 Bursa të kompanisë “EURO ACTIVA”

- **1 bursë** për ciklin e parë të studimeve

Kushtet, kriteret e përzgjedhjes, lartësia e bursës si dhe mënyra dhe afati i aplikimit për programet e veçanta janë të ngjashme me bursat meritore që i ofron UEJL dhe HESP ndërsa hollësitë do mund t'i gjeni në ueb faqen e Universitetit www.seeeu.edu.mk ose në Zyrën për ndihma financiare në UEJL.

4 Programi “PUNO DHE STUDIO”

Programi “*Puno dhe studio*” përkrah studentët në aspektin financiar dhe në të njëjtën kohë iu mundëson studentëve që të marrin eksperiencë pune dhe të demonstrojnë aftësitë e tyre profesionale.

- Në vitin akademik 2011/2012 do të ofrohen **80-100** vende pune në këtë program.
- Angazhimi maksimal është deri në 15 orë pune në javë dhe studenti mund të angazhohet më së shumti deri në shlyerjen e shkollimit të një viti akademik gjatë kohëzgjatjes së studimeve.
- Të drejtë aplikimi në programin “Puno dhe studio” kanë të gjithë studentët, por përparësi do të kenë studentët që do të dëshmojnë se kanë nevojë për përkrahje financiare si dhe të dëshmojnë shkathtësi për vendin e punës.

Informata rreth afatit dhe mënyrës së aplikimit mund të merren në Zyrën për Ndhma Financiare në UEJL.

5 Përkrahje financiare për studentin e dytë apo të tretë të familjes

Qëllimi i këtij programi është që të përkrah familjet që kanë dy apo më shumë studentë që studiojnë në UEJL (vetëm anëtarë të familjes së ngushtë) dhe që nuk përfitojnë nga programet tjera të ndihmës financiare që i mundëson Universiteti.

Shkalla e përkrahjes financiare:

- Studenti i parë i familjes paguan 100% të shkollimit;
- Studenti i dytë i familjes paguan 85% të shkollimit;
- Studenti i tretë i familjes paguan 75% të shkollimit;

Lehtësimi financiar aplikohet te studentët që nuk janë shfrytëzues të ndonjë burse, granti apo të ndonjë programi tjetër të ndihmës financiare që administrohet nga UEJL ose institucione tjera.

6 Kredi studentore

Në bashkëpunim me bankat në vend, studentëve të UEJL-së iu mundësohet kredi studentore me interes të volitshëm. Në vijim janë ofertat e dy bankave që mundësojnë kredi studentore:

NLB Tutunska Banka

Kalkulimi i këstit mujor për pagesa me kartelën *Master Standard*

Participimi	Interesi	Gjithësejt	Kësti mujor
A	B (A*6,5%)	C (A+B)	D (C/12muaj)
1300 €	85 €	1.385 €	€115 €

1500 €	98 €	1.598 €	€133 €
1900 €	124 €	2.024 €	€169 €
2000 €	130 €	2.130 €	€178 €

6,5% është interesi real vjetor (sa do t'i kushtojë studentit)

Stopanska Banka a.d Shkup

Përshkrimi i kredisë	Kredi deri me 300.000 MKD Pagesën e shumës së kredisë të miratuar në para të gatshme.	
Shuma	• 15.000 MKD – 300.000 MKD	
Valuta	• Kredi në Denar	
Norma e interesit (vjetore)	Klient me rrogë në SB	Klient tjerë
	• 10,80% e ndryshueshme	• 12,00% e ndryshueshme
	<i>SB bazuar në rregulativen aktuale ,regullisht publikon normën vjetore të interesit të shpenzimeve të përgjithshme (SVT) në ueb faqen e vet, në tabelat publike në sportelet e bankës si dhe në mediumet publike.</i>	
Afati i kthimit	Prej 6 deri 84 muaj (7 vite)	

Kushtet aplikimit si dhe të gjitha informatat shtesë për kredi studentore mund që t'i merrni në Zyren për ndihma financiare në UEJL ose direkt në filialet/ekspoziturat e bankave gjegjëse.